



Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur në takimin e Ekzekutivit të Komunës me qytetarë të Lluzhanit dhe fshatrave përreth, mbajtur më 09 gusht 2019

Takimi filloi në orën 14;10, dhe u mbajt në SHFMU “Afrimi e Fahriu” në fshatin Lluzhan. Takimin e hapi dhe kryesoi z.Isuf Latifi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, i shoqëruar nga Faik Muçiqi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë të evidentuar dhe nënshkruar në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë e këtij procesverbali.

Tema: Dëgjim buxhetor rreth përgatitjes së propozim Buxhetit të Komunës për vitin 2020 dhe prioritetet për vitet 2021/2022

Isuf Latifi, drejtor i DBF, e hapi takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje që e vlerësoj mjaft të rëndësishëm për lokalitetet e kësaj ane, ndër të tjera theksoi.

Sikurse për çdo vit, gjatë këtyre muajve Komuna zhvillon procesin e përgatitjes së projektbuxhetit për vitin e ardhshëm dhe prioritetet për dy vitet në vijim, e që afati i miratimit është fundi i muajit shtator, buxhet i cili është përcaktuar fillimisht mbi bazën e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020/01 dhe Qarkores Buxhetore 2020/01 të Ministrisë së Financave si dhe projeksionet fillestare të projekteve kapitale, që do të përfshihen në projektbuxhetin e Komunës, prandaj me qëllim të transparencës dhe që qytetarët të jenë pjesë e përgatitjes së projektbuxhetit përkatësisht pjesë e vendimmarrjes, organizohen edhe takime të tilla qëllimi i të cilave është që qytetarët të paraqesin nevojat dhe prioritetet e investimeve në secilin lokalitet, të cilat pasi të analizohen dhe vlerësohen si me interes mund të jenë të përfshira në planifikimet buxhetore të Komunës, kjo ngase për propozime, kërkesa, duhet të ketë një arsyeshmëri për shkak që secili projekt duhet t'i përmbush disa kriteret për të qenë i përfshirë në planifikime buxhetore.

Prezent këtu është edhe Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit si dhe zyrtari përkatës i cili mban procesverbal, përkatësisht do të japim sqarime dhe përgjigje të ndryshme në raste se paraqitet nevoja si dhe do të evidentojmë kërkesat e juaja dhe varësisht natyrës së tyre do t'ju përcjellim Drejtorive përkatëse, andaj pa humbur kohë, fjala është për Ju të nderuar pjesëmarrës dhe kërkoj që të kontribuoni me propozime dhe kërkesa për investime në projekte konkrete.

Avni Humolli, nga fshati Lupç i Poshtëm, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës rreth 130 m, në lagjen Humolli

Shaip Hoxha, nga fshati Penuhë, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës në lagjen Hoxha, për të cilën tha se baza ekziston.

Naser Çunaku, nga fshati Llugë, paraqiti kërkesat;

-Të ndërmerren masa nga Drejtoria e Inspeksionit lidhur me ndotjen ekstreme të lumit nga mbetjet e një fabrike (rast ky i njohur për Komunën),

-Asfaltimin e 4 rrugëve sekondare të fshatit nga rreth 100-150 m.

Rigon Begolli, nga fshati Lluzhan, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rr. “Vëllezërit Begolli”.

Valentina Sylja, nga fshati Shakovicë, paraqiti kërkesat;

-Asfaltimin e rr. “Ismajl Kapiti” – lagjet Sylja dhe Musliu.

-Kërkesë për ndërtimin e një Çerdheje, e nevojshme për këto lokalitete.

-Shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në fshatin Shakovicë,

-Rregullimin me zhavorr të disa rrugëve të fshatit si dhe shtrirjen e rrjetit të kanalizimit në disa lagje.

Rrustem Jetullahu, përfaqësues i fshatit Shakovicë, paraqiti disa kërkesa për të cilat tha se të njëjtat i kam paraqitur edhe me shkrim në Drejtoritë përkatëse, dhe atë;

-Asfaltimi i rrugëve - rrugicave, rr.“Rexh Zhitia” rreth 350m, rr.”Afrim Murati” rreth 250 m, rruga e lagjes Azemi në gjatësi rreth 300 m, rr.”Ismajl Kapiti” , rruga e lagjes Elezi.

-Shtrirja e rrjetit të kanalizimit nga “market fita” e tutje, më se e nevojshme, si dhe në lagjen Sylja

-Shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik.

-Ndërtimi i një terreni sportiv, lokacioni ekziston

-Ndërtimi i një Çerdheje publike për këtë rrethinë.

-Ndërtimi i një ure e cila lidh fshatrat Shakovicë – Lluzhan.

Zenun Bunjaku, nga fshati Sallabajë, theksoi, natyrisht që kërkesat gjithnjë janë të mëdha por konsideroj se është mirë të potencohen vetëm ato që janë më me prioritet për secilin lokalitet.

Kërkesë e imja është;

-Asfaltimi i disa rrugëve dhe rrugicave në disa lagje të fshatit,

-Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në lagjen ku unë jetoj, gjatësi rreth 120 m.

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, sqarimi parafolësit, ndërtimi i kanalizimit në atë lagje do të kryhet në këtë vit që jemi, tani veç janë duke u bërë punime.

Enver Bunjaku, nga fshati Sallabajë, paraqiti kërkesat;

-Realizimi i projekteve të hartuara nga banorët e fshatit dhe të dorëzuara para rreth 5 viteve në Komunën e Podujevës,

-Asfaltimi i rrugëve në lagjet Avdyli dhe Ajeti,

-Asfaltimi i disa rrugëve të shkurtra sekondare në brendësi të fshatit,

-Asfaltimi i rrugës në lagjen përball Xhamisë në fshatin Lluzhan,

-Rregullimi me zhavorr i rrugës rreth 1200 m, (e njohur si rruga te kisha) e cila lidh pothuajse gjithë fshatin, dhe rrugës në drejtim të Odës së fshatit.

-Rregullimi i trotuarit me kubëza dhe shtrirja e rrjetit të ndriçimit publik në rrugët kryesore të fshatit,

-Vendosje e një table 7.5 ton, në një rrugë të fshatit sepse kamion të ndryshëm me peshë më të madhe kalojnë në atë rrugë dhe shkaktojnë dëme.

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, jep disa sqarime për projekte të asfaltimit në disa fshatra të rrethinës së Lluzhanit që kanë kaluar në Kuvend përkatësisht të parapara me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020/01.

Sa i përket ndriçimit publik në rrugën magjistrale, ka qenë në planifikim por e kemi tërhequr për shkak të punimeve për zgjerimin e kësaj rruge, e njëjta ka ndodh edhe sa i përket trotuarit.

Sejdi kamberi, përfaqësues i fshatit Majac, fillimisht shprehi falënderime sa i përket investimeve në fshatin Majac, paraqiti kërkesat, si në vijim;

-Asfaltimin e rrugëve në pjesën e epërme të fshatit, projektet e të cilave janë hartuar nga vetë banorët.

-Ndriçim publik në brendësi të fshatit.

-Zgjerimi i lumit (tek Zhegrovët)

-Asfaltimi i rrugës rreth 150 m, në hyrje të fshatit ku jetojnë rreth 8 familje, dhe e cila lidhet me pjesën e poshtme të fshatit ku ka shumë toka të punueshme, e nevojshme që në këtë vit të rregullohet me zhavorr kurse në vitin 2020 të asfaltohet.

-Intervenim në rrugën në drejtim të Zhegrovës, të paktën me zhavorr nëse nuk ka mundësi për asfaltim, sepse është në gjendje jo të mirë dhe janë dy familje të cilat jetojnë në atë pjesë.

Ibrahim Gashi, nga fshati Majac, paraqiti kërkesën për rregullimin me asfaltim apo edhe me zhavorr të rrugës rreth 3.5 km, e ashtuquajtur rruga e Zhegrovëve. Kjo për shkak se unë jetoj në atë pjesë dhe jam fermer, andaj shpesh ndodh të paraqiten vështirësi sa i përket kalimit në atë rrugë.

Bajram Tullari, nga fshati Tërnavë, paraqiti kërkesat;

-Ndërtimi i trotuarit në brendësi të fshatit dhe në disa rrugë të tjera

-Asfaltimi i rrugës në drejtim të varrezave

-Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në disa pjesë të fshatit.

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, sqarime parafolësit, ndërtimi i trotuarit dhe kanalizimit në fshatin Tërnavë është në procedurë të prokurimit dhe pritet të kryhet në vitin 2019, pasta është edhe rregullimi i trotuarit me kubëza në rrugën Shakovicë – Tërnavë.

Fadil Gërguri, nga fshati Llugë, paraqiti kërkesat;

-Pastimi i lumit që kalon nëpër fshat, kërkesë emergjente ngase kundërmon shumë nga hedhjet e ndryshme që bëhen nga dikush që për ne banorët është i identifikuar, por që nuk është ndërmarr asgjë asnjëherë e që Komunën nuk e shoh fajtores në këtë rast sepse ndotja bëhet në mënyrë tinxare dhe me qëllim.

-Kemi edhe nevojën e ndërtimit të urës tek lagja Rrahmani e cila lidh rrugët kryesore të fshatit, kërkesë kjoq e cila ka qenë edhe vitin e kaluar por si duket nuk është kuptuar mirë dhe ka hyrë në planifikime dhe është duke u ndërtuar një urë tjetër në atë rrethinë.

-Ndërtimi i një ure te lagja Llumnica.

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, sqarim parafolësit, ndërtimi i urës në lagjen Rrahmani është duke u ndërtuar në bazë të kërkesës që është bërë në vitin e kaluar, ndoshta ka mund të mos jemi qartësuar mjaft por kërkesa ka qenë e tillë dhe ne e kemi përfshirë në planifikime për 2019 dhe tani është duke u ndërtuar, mirëpo ta shikojmë se a mund të përfshijmë edhe atë urë në vitin 2020.

Nuredin Hyseni, përfaqësues i fshatit Bellopojë, paraqiti kërkesat;

-Ndërtimi i kanalizimit në hyrje të fshatit dhe te lagja Ferizi,

-Asfaltimi i 6 rrugicave të lagjeve që lidhen me rr.”Kadri Avdiu”

-Vazhdimi i shtrirjes së ndërtimit të trotuarit në afërsi të shkollës, projekt ky i cili është duke u realizuar në këtë vite që jemi por që kërkesa është për vazhdimin e tij edhe në vitin 2020.

-Ndërtimi i kanalizimit atmosferik te lagja Qerimi.

Adem Ramadani, nga fshati Bellopojë, fillimisht paraqiti kërkesën për ndryshimin e kahjes së ndërtimit të trotuarit, siç potencoi, është duke u ndërtuar gabimisht sepse më rëndësishme është të ndërtohet në anën e kundërt sepse lidhen më shumë lagje dhe ka frekuentim më të madh të nxënësve.

-Të rregullohet ngrohja e shkollës,

-Intervenim në shkollën e fshatit (dyer, dritare, etj)

-Ndërtimi i një terreni sportiv në hapësirat e shkollës,

-Shtrirja e rrjetit të kanalizimit te lagja Mustafa,

-Të ndërmerren masa sa i përket mbeturinave që hudhen vend e pavend.

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, sqarim parafolësit, sa i përket ndërtimit të trotuarit, qëllimi ka qenë që t’iu mundësohet qarkullim më i lehtë nxënësve që shkojnë në shkollë dhe kalojnë nëpër atë rrugë, ndërsa për vitin 2020 do të analizojmë gjendjen dhe shpresoj se do të kemi buxhet të mjaftueshëm që të përfundoj tërësisht trotuari në fshatin Bellopojë.

Shaban Menxhiqi, nga fshati Lupç i Poshtëm, paraqiti kërkesën për rregullimin me zhavorr rrugën “Hasan Shabani”

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, sqarim parafolësit, për rrugën e cekur, ka dal një komision dhe ka analizuar gjendjen e asaj rruge dhe ka konstatuar se nuk është në gjendje të keqe, mirëpo edhe pavarësisht kësaj ne do të shikojmë mundësit tona që të intervenojmë në atë rrugë.

Naim Mehmeti, nga fshati Halabak, fillimisht shprehi falënderime për investimet e bëra në fshatin Halabak e që nuk janë të pakta, mirëpo edhe përkundër kësaj kam 2 kërkesa;

-Rregullimi me zhavorr i rrugës rreth 2 km, te lagja Nelaku,

-Vendosja e rrethojave të shkollës së fshatit Halabak

Fadil Bici, përfaqësues i fshatit Godishnjak, paraqiti kërkesat;

-Asfaltimin e disa rrugëve – rrugicave në disa lagje, (rruga e Rafet Berishës, rruga e Emin Bicit, rruga e lagjes Kastrati, rruga e Safet Xhemës, dhe rruga e Adem Bicit),

-Kërkesë për ndërtimin e një shtëpie të banimit për familjen e Skender Berishës i cili është në gjendje të rëndë ekonomike – sociale dhe të banimit,

-Rregullimi (prej gome) i fushës sportive të shkollës së fshatit Lluzhan, kjo për shkak të se fusha është me beton – asfalt dhe gjatë aktiviteteve po ka raste kur nxënësit po lëdohen, andaj do të ishte mirë të ndërhyhet në këtë drejtim.

Isuf latifi, drejtor i DBF, i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje në takim. Theksoi, ne i morëm të gjitha kërkesat e juaja dhe për disa veç u dhanë sqarime, natyrisht që të gjitha do t'i analizojmë dhe do t'i vlerësojmë me qëllim të përfshirjes së tyre në planifikimet trevjeçare buxhetore të Komunës, andaj me qaj e konstatoi të mbyllura këtë takim.

Takimi përfundoi në orën 15:30

Procesverbalin e mbajti:

Enis Sheholli

Nr.prot.04-400/01-0065574/19

Podujevë,

09 gusht 2019

Drejtori i DBF

Isuf Latifi